



NGJITE KËTU

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Koha për zgjidhje: 240 minuta

Gusht, 2009

Shifra e vlerësuesit TË PARË

Shkruaj
këtu:

Shifra e vlerësuesit TË DYTË

NGJITE KËTU

UDHËZIM PËR KANDIDATIN

Lexoje me kujdes udhëzimin! Mos lër asgjë pa lexuar!

Ngjite njëren shifër në vendin e caktuar të testit („Shifra e kandidatit“), kurse shifrën tjetër në vendin e caktuar në listën e përgjigjeve.

Mos i shfleto faqet dhe mos fillo t'i zgjidhësh detyrat pa të dhënë leje mbikëqyrësi.

Testi përmban detyra.

Detyrave duhet t'u përgjigjesh në këtë mënyrë:

- duke rrethuar shkronjën para përgjigjes së saktë;
- duke plotësuar fjalinë me përgjigjet e ofruara;
- duke shkruar tekst në vendin që është paraparë për atë;
- duke shkëputur pjesë (fjalë, grup fjalësh, fjali ose pasuse nga tekstet e dhëna) etj.

Gjatë dhënies së përgjigjeve duhet të kesh kujdes për mënyrën e të shprehurit dhe për zbatimin e normave drejtshkrimore. **Shkruaj lexueshëm.** Përgjigjet që nuk lexohen, shkarravitjet ose të rrethuarit e më shumë varianteve vlerësohen me zero (0) pikë.

Si në test, ashtu edhe në listën e përgjigjeve, shkruaj me stilolaps. Përgjigjet dhe detyrat e shkruara me laps, vlerësohen me zero pikë. **Pranë çdo pyetjeje dhe detyre janë dhënë pikat për përgjigjen e saktë.**

Rreptësisht ndalohet kopjimi. Të gjitha tekstet identike ose të ngjashme si dhe tekstet e shkruara me dorëshkrime të ndryshme vlerësohen me (0) pikë.

Së pari zgjidhen detyrat në test. Pasi t'u përgjigjesh pyetjeve në test, përgjigjet e detyrave barti në listën e përgjigjeve, sipas udhëzimit për plotësim të dhënë në të.

Të urojmë sukses!

FAQE E ZBRAZËT



1 Lexoje me vëmendje tekstin e mëposhtëm.

Sot më vdiq mamaja. Apo ndoshta dje, nuk e di. Mora një telegram nga azili: „Nëna vdiq. Varrimi nesër. Ngushëllime të sinqerta.” Kjo s’do të thotë asgjë. Ndoshta ka ndodhur dje.

Azili i pleqve ndodhet në Marengo, tetëdhjetë kilometra larg Algjerit. Do të marr autobusin e orës dy dhe do të jem aty pasdite. Kështu do të mund ta gdhij një natë e do të kthehem nesër mbrëma. I kërkova dy ditë leje pronarit dhe ai nuk mund të mos m’i jepte për një arsye të tillë. Por m’u duk se nuk i pëlqeu. Madje dhe i thashë: „S’është për fajin tim.” Nuk u përgjigj. Atëherë mendova se nuk duhej t’ia kisha thënë ato fjalë. Sidoqoftë nuk kisha pse të kërkoja ndjesë. Ai bile duhej të më shprehte ngushëllimet. Do ta bëjë padyshim pasnesër, kur të më shohë në zi. Tani për tani duket sikur mamaja nuk ka vdekur. Ndërsa pas varrimit do të jetë çështje e mbyllur dhe çdo gjë do të ketë marrë formë më zyrtare.

Në orën dy mora autobusin. Bënte shumë nxehtë. Hëngra në restorant, te Çelesta, si zakonisht. Të gjithëve u vinte shumë keq për mua dhe Çelesta më tha: „Vetëm një nënë kemi”. Kur u largova, më shoqëruan deri te dera. Isha disi i hutuar ngaqë m’u desh të ngjitesha tek Emanueli për t’i marrë hua një kravatë të zezë dhe një shirit të zi. Ai ka humbur xhaxhanë para disa muajsh.

Vrapova të kap autobusin. Gjithë ai nxitim e ai vrap, me siguri për shkak të tyre, le pastaj edhe troshitjet, era e benzinës, afshi i nxehtë që vinte nga rruga e nga qielli, më vunë në gjumë. Fjeta thujse gjatë gjithë rrugës.

(Fragment nga „I huaji“ - Albert Kamy)

(1.1) Ç'ndien Merso-ja me rastin e vdekjes të së ëmës?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Pikëllim.
- B. Hidhërim.
- C. Indiferencë.

1 pikë

(1.2) Si e arsyeton kërkesën për leje para pronarit?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Në formë zyrtare.
- B. Me arrogancë.
- C. Me shqetësim.

1 pikë

(1.3) Cilën formë të të shprehurit përdor autori në pjesën e fundit të fragmentit të dhënë?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Përshkrimin.
- B. Krahasimin.
- C. Dialogun.

1 pikë

(1.4) Ideja kryesore e romanit „I huaji” bazohet në:

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Mitin e Orfeut.
- B. Mitin e Sizifit.
- C. Mitin e Atenës.

1 pikë

(1.5) Ku e sheh Kamy-ja daljen nga pakuptimësia e jetës?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Në shpresën për ardhmërinë.
- B. Në kryengritjen për ndryshime.
- C. Në pajtimin me fatin.

1 pikë

37

Çoh, i bijt e Spanjës! Po ju thurret në luftë
Perndesha juaj e moçme e Kalorisisë
S'e tund posi qëmoti ushtë etëplotën,
S'i valavitet n'ajr puplaj; e kuqe-
Po fluturon në tym të gjulevet
Të topit, atje tej, dhe bubullon
Me çdo të shtënë topi: "Çohuni!"
Mos është sot më i dobët zëri i saj
Se sa kushtrimi i saj në zall t'Andaluzisë?

38

A nuk dëgjuat trokëllimë kuajsh?
A nuk gjëmon në plajë ushtimë e luftës?
Nuk patë kë goditi shpat e gjaktë,
Përse s'i mbroni vllzërit nga tirani.
Nga sklevërit e tiranit? Zjarri i vdekjes
Flakëron kudo. Çdo batore nga brigjet
Lajmon se mijra trima japin frymën,
Në erën sulfurike kalon Morti,
Qëllon me sqelme Marsi i kuq e popuj dridhen
.....

(Fragment nga „Çajld **Harold**” - Xh.G.Bajron)

(2.1) Kujt i drejtohet poeti në vargjet e strofës nr. 37?

1 pikë

1	2
---	---

(2.2) Sipas vargjeve të strofës nr. 38 nga kush duhet të mbrohen popujt e robëruar?

1 pikë

1	2
---	---

(2.3) Në vargun „*Nuk patë kë goditi shpat e gjaktë*“, cila figurë stilistike shprehet me mbiemrin e përdorur?

1 pikë

1	2
---	---

(2.4) Çfarë lloji letrar është vepra „*Vdekja e Çajld Harolldit*“?

1 pikë

1	2
---	---

(2.5) Cililit drejtim letrar i takon krijimtaria e Bajronit?

1 pikë

1	2
---	---

3 Lexoje me vëmendje tekstin e mëposhtëm.

Në mes të shtegtisë së kësaj jete
u gjeta në një pyll krejt errësi,
se kishe humbë unë rrugën e vërtetë.

Si ish ta them sa kam vështirësi 4
ai i egri pyll, i ashpër, pyll hata,
sa ta mejtoj më kall frikë përsëri!

Veçse ma i idhtë në qoftë vdekja paksa! 7
Po me tregue ç'të mirë kam gjetë n'atë anë,
do flas për sende tjera që kam pa.

Si hyna mbrendë as unë s'di me ju thanë, 10
aq gjumë i fortë qepallat kish randue,
kur rrugën e vërtetë e pata lanë.

Po kur te rranza e kodrës qeshë afrue, 13
atje ku merrte fund ajo luginë,
që me aq tmer në zemër m'kish trazue,

vështrova lart e pashë se si në shpinë 16
po vishej krejt nga rrezet e planetit,
që në gjithë shtigjet njerëzve u prin.

At'herë veç frika m'iku pak të shkretit 19
e zemrën unë e ndjeva ma të lirë
nga nata, që kalova mes sikletit.

Si ai, që tue marrë frymë me të vështirë, 22
prej detit del në breg e nga ato valë
aq të rrezikshme sytë e vet i prir,

dhe shpirti im, që ikte pa u ndalë, 25
mbrapa u suell me pa atë rrugën trishte,
që s'la njeri të gjallë andej me dalë.

Dërmue, si u çlodha pak mbi atë gurishte, 28
ia nisa rrugës nëpër breg t'shkretuem,
çdo herë kamba e ndalun ma poshtë ishte.

(„*Ferri*” – Dante Aligeri)

(3.1) Për çka flet poeti në fragmentin e dhënë?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Për jetën e tij.
- B. Për bukuritë e pyllit.
- C. Për të dashurën e tij.

1 pikë

(3.2) Sipas strofës së dytë të këtij fragmenti, poeti ndjen:

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. hidhërim.
- B. krenari.
- C. frikë.

1 pikë

(3.3) Në fragmentin e dhënë „Pylli i egër” e simbolizon:

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. jetën pa mëkate.
- B. jetën me mëkate.
- C. jetën pa brenga.

1 pikë

(3.4) Dante Aligeri është paralajmëruar i:

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Romantizmit.
- B. Humanizmit dhe Renesancës.
- C. Klasicizmit.

1 pikë

(3.5) „Ferrī” është pjesë përbërëse e:

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. „Komedisë njerëzore”.
- B. „Komedisë hyjnore”.
- C. „Komedisë botërore”.

1 pikë

4 Lexoje tekstin në vijim, pastaj përgjigju pyetjeve.

Nëpër luginat e maleve përshkohet malësori vetëm me një këmishë e brekë legjendare mbi shtat për me arrijtë në qendrën e nëprefekturës, me marrë misër. Krahnori i tij asht një copë graniti që u shkëput nga mali dhe u vendos mbi dy kambë të drejta e të forta si landa e pyllit. Dhe lëvizet copa e malit pa bëzajtë. E përpara depos së misrit bjerr cilsin' karakteristike të vetën, dhe bahet frikacak. Bahet servil, frikacak, pse, - mendoj ai- njashtu e don ligji, nëpunësi; përndryshe s'ka misër. "Si urdhnon zotni" përsëritet sa e sa herë në mënyrë qesharake, me të marrun zani, me gjeste majmuni - vetëm e vetëm mos me zgjua mninë e engjujvet që ndajnë misër.

Dhe kur marrin misrin, nisen njeni mbas tjetrit gjatë udhës së ngushtë të malit dhe të jetës. - Ndodh që njenit i derdhen kokrrat e misrit nëpër birë të vogël të thesit, shoku mbrapa, pa i pa, i shkel; i treti shok as një as dy, - por ja hjedh mallkimin e pamshirshëm: "Mos i shkel he të shitofitë Zana!" Se shekulli i njëzet asht shekulli i apoteozës së misrit ndër folet e shqipeve.

(Fragment nga „Legjenda e misrit”- Migjeni)

(4.1) Cilën temë trajton poeti në këtë fragment?

1 pikë

1	2
---	---

(4.2) Si janë të veshur fshatarët?

1 pikë

1	2
---	---

(4.3) Pse malëtori bëhet frikacak përpara depos së misrit?

1 pikë

1	2
---	---

(4.4) Çfarë lloji i krijimit letrar është „*Legjenda e misrit*”?

1 pikë

1	2
---	---

(4.5) Formën gramatikore: me marrë misër - shkruajeni në formën letrare standarde shqipe.

1 pikë

1	2
---	---

SERAFINA TOPIA

Vashë, rritesha plot hire
Tek vatra e prindërvet:
Si një pemë e sapoardhur
Hijekëndshme më rritet
Në kopshtin e perandorit¹⁾
vashë u rrita e zalisur
Nga gjitone e nga të huaja
Si të ndjeja shi e breshër
Që mbi tjegulla kërcisnin,
a të prehesha e dirsur
përkundrejt të korravet,
mua më gëzohej zemra,
si djalthit q'e zgjojnë natën
për të vajturë në det,
dhe që sheh nga qertja e s'ëmës
yjet një mori kandilash
përmi maja lisash lart,
si një botë shumë e largët
që nga dita e tij e shkollës.

¹⁾ *perandorit* - këtu mendon në perandorin Bizantin

*(Fragment nga vepra „Serafina Topia”
– libri I-kënga e parë- Jeronim de Rada)*

(5.1) **Kujt i drejtohet poeti në vargjet e fragmentit të mësipërm?**

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Serafinës.
- B. Atdheut.
- C. Prindërve.

1 pikë

(5.2) **Në vargjet e fragmentit të mësipërm mbretëron:**

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. atmosferë e zymtë.
- B. atmosferë ironie.
- C. atmosferë lumturie.

1 pikë

(5.3) **Vepra „Serafina Topia“ është poemë:**

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. lirike.
- B. epiko-lirike.
- C. epike.

1 pikë

(5.4) **Në cilën vetë zhvillohet rrëfimi në vargjet e fragmentit të mësipërm?**

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Në vetën e parë.
- B. Në vetën e dytë.
- C. Në vetën e tretë.

1 pikë

(5.5) **Në vargun *mua më gëzohej zemra*, fjalët mua më kryejnë funksionin sintaksor të:**

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. kundrinës së drejtë.
- B. kundrinës me parafjalë.
- C. kundrinës së zhdrejtë.

1 pikë

BABA TOMORRI

Shqipëtarët si dhe bagëtia
Cbathur, çveshur, vdesin nga uria.
Shqipëtarët? Sot s'ka Shqipëtarë
Turku, Greku, na kanë përndarë.
Prifti, hoxha, kisha dhe xhamia,
Na gënjejnë... U prish Shqipëria...
Baba Tomorr, o mal' i uruar,
Çdo të ngjajnë të lutem rrëfemi.
Do të heq shumë Shqipëria?
Fshiu lotë dhe më tha Tomorri:
O Shqipëtarët' e gJORë,
Ndëgjoni Baba Tomorrë:
Kombi juaj s'vete mbarë
Se besët u kanë
Besa e bashkon njerinë
Ju pse ndani Perëndinë?
Të krishter dhe myslimanë
Gjithë një Perëndi kanë;
Ini një gjak more të mjerë,
Se ndë një vend keni lerë;
Ini gjithë Shqipëtarë.

(Fragment nga „Baba Tomorri” - Çajupi)

(6.1) Në katër vargjet e para poeti flet për:

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. një të kaluar para kohës kur jetonte poeti.
- B. kohën kur jetonte poeti.
- C. kohën që do të vijë.

1 pikë

(6.2) Sipas poetit, kush i ka përçarë shqiptarët?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Kisha e xhamia.
- B. Perëndia.
- C. Besa.

1 pikë

(6.3) Në vargun Fshiu lotë dhe më tha Tomorri poeti përdor:

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. personifikimin.
- B. hiperbolën.
- C. antitezën.

1 pikë

(6.4) Po në pesë vargjet e fundit në se thërret poeti?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Në unitet fetar.
- B. Në unitet klasor.
- C. Në unitet kombëtar.

1 pikë

(6.5) Kjo poezi ka motiv:

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. social.
- B. patriotik.
- C. erotik.

1 pikë

7 Lexoje tekstin me vëmendje, mandej përgjigju pyetjeve.

Cila ishte kjo grua që si ndonjë fantazmë, futej tinëz në mes të natës në dhomën e Bardhës?

Sapo u ngrit më këmbë mbi dysheme, iu afrua Bardhës që të sigurohej se po flinte; pastaj pa derën dhe pa se ishte mbyllur brenda. Iu afrua Bardhës lehtë-lehtë e pa e ndier. Fytyra e gruas së re vetëtinte nga bukuria; një hije e lehtë melankolie u jepte tipareve të saj diçka poetike dhe hyjnore... Por vështrimi i egër i shtrigës nuk u ndal në atë fytyrë të bukur, sytë e saj të ndezur flakë, si sytë e hienës, kërkonin kraharorin e Bardhës, atë kraharor të bardhë si alabastrin, gjysmë të zbuluar e që një frymëmarrje e njëllajtë e ngrinte lehtë e me ngadalë.

Ajo nxori më në fund pistoletën e fshehur në përparëse, mbështeti tytën në zemrën e viktimës dhe hoqi këmbëzën. Arma u shkreh dhe bëri një zhurmë të mbytur. Dhoma u mbush me tym dhe me një erë sqfuri. Kjo dhomë që kishte qenë dëshmitare e dhembjeve të një engjëllusheje, u shndërrua në një shpellë skëterre, në një limer krimi e vrasjeje.

Bardha nuk bëri kurrfarë lëvizjeje, nuk lëshoi asnjë klithmë, ajo mbajti atë pozë që kishte marrë tek e kishte zënë gjumi; vetëm hapi sytë dhe për një çast i hodhi një vështrim të mekur xhelatit të vet.

Plumbi e kishte përshkruar tejprtej atë zemër të thjeshtë e të zjarrtë.

- E lava me gjakun e saj gabimin e tim biri,- murmuriti vrasësja e neveritshme, duke lëshuar armën fare pranë afër divanit ku po dergjej viktimën. Dhe me shpejtësinë e shkathtësinë e tigrin, u fut në vrimën nga kishte ardhur, lëshoi kapaxhën e u zhduk në errësirën e bodrumit.

(Fragment nga „*Bardha e Temalit*” - Pashko Vasa)

(7.1) Cila është tema kryesore në këtë fragment?

1 pikë

1

2

(7.2) Kush e vrau Bardhën?

1 pikë

1

2

(7.3) Cila figurë stilistike shprehet me konstruktet: si ndonjë fantazmë, si sytë e hienës, si alabastrin?

1 pikë

1

2

(7.4) Çfarë lloji i prozës është vepra „*Bardha e Temalit*”?

1 pikë

1

2

8 Në fjalinë: *Shumica e shkrimtarëve tanë i shërbyen atdheut me penë e pushkë në dorë* emri atdheut është në rasën:

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. kallëzore.
- B. gjjinore.
- C. dhanore.

1 pikë

9 Periudha: *Korrupsioni gjendet kudo, kurse talenti është gjë e rrallë* është periudhë me marrëdhënie bashkërenditëse:

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. këpujore.
- B. përmbyllëse.
- C. kundërshtore.

1 pikë

10 Format foljore ulu, dashurohu janë përdorur në:

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. mënyrën dëftore.
- B. mënyrën urdhërore.
- C. mënyrën kushtore.

1 pikë

11 Në fjalinë e dytë të periudhës: *Tani janë bashkë, pas pak orësh mund të ndahen përjetë* - kallëzuesi i nënvizuar është:

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. kallëzues i përbërë foljor.
- B. kallëzues i thjeshtë foljor.
- C. kallëzues emëror.

1 pikë

12 Emri mik shumësin e formon me:

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. metafofi.
- B. palatalizim.
- C. apofoni.

1 pikë

13 Në shkallën sipërore është mbiemri:

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. shumë i mirë.
- B. më i mirë.
- C. i mirë.

1 pikë

14 Forma përcjellore e foljes punoj është:

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. për të punuar.
- B. punuar.
- C. duke punuar.

1 pikë

15 Në gjuhën shqipe bashkëtingëllore dridhëse janë:

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. m, b
- B. k, g
- C. r, rr

1 pikë

16 Cila formë është shkruar drejt?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Ta marrësh.
- B. Ta marrish.
- C. T'a marrish.

1 pikë

17 Në morfologji fjala menjëherë është:

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. ndajfolje.
- B. mbiemër.
- C. përemër.

1 pikë

SHËRBIMET E FSHEHTA MË TË RËNDËSISHME NË BOTË

CIA

Agjencia Amerikane e Inteligjencës ka tre funksione të deklaruar.

- 1) Përfitim dhe analizimin e informacionit mbi të huajt.
- 2) Propagandën dhe marrëdhëniet publike
- 3) Operacionet e fshehta nën urdhrat e Presidentit.

Cia-s iu dha liri veprimi e madhe gjatë Luftës së Ftohtë, ndërkohë që Qeveria amerikane mendonte se një pushtet i tillë i pakufi ishte i nevojshëm për të luftuar me sukses Agjencinë e Bashkimit Sovjetik, KGB-në. Si rezultat, CIA u përfshi në më shumë goditje jashtë vendit si në Kili, Kongo dhe Kubë.

MI6

MI6 u krijua vetëm pak para fillimit të Luftës së Parë Botërore, fillimisht për të mbikëqyrur aktivitetet e Gjermanisë. Që atëherë, MI6 është përfshirë plotësisht në konflikte të mëdha të shekullit të 20-të dhe të 21. Edhe përpara sulmeve të 11 shtatorit MI6 bashkëpunoi në mënyrë aktive me CIA-n për të shkëmbyer informacione. MI6 së bashku me CIA-n kanë shkaktuar përmbyshjen e shumë regjimeve, siç është ajo e Kongos në vitin 1961 dhe e Iranit në vitin 1953.

GRU

Kur dikujt i vjen në mendje Inteligjenca e Ruisë, mendja i shkon menjëherë tek KGB-ja. Por ndërkohë që KGB-ja u shkri në vitin '95 nga Boris Jelcin, Agjencia e Shërbimeve të Fshehta, akoma më e vjetër, GRU, nuk u prek fare nga shpërbërja e Bashkimit Sovjetik. E krijuar në vitin 1918 nga Lenini, fillimisht kjo agjenci kishte detyrën për të trajtuar Intelegjencën Ushtarake.

DGSE

DGSE është formuar vetëm në vitin 1982, si zëvendësim i shërbimit më të vjetër të Inteligjencës, SDCE. Ky shërbim i ri u bë menjëherë përgjegjës për mbledhjen e Inteligjencës si dhe për zbulimin e aktiviteteve të jashtme të aktiviteteve të spiunazhit të vendeve të tjera që preknin interesat e Francës.

BND

Agjencia paraardhëse e BND u krijua fillimisht para Luftës së Dytë Botërore me qëllimin për të vëzhguar Bashkimin Sovjetik. Në ditët e sotme ajo ka si detyrë të njoftojë Qeverinë gjermane për cënimin e interesave të vendit jashtë kufijve. Buxheti vjetor i BND arrin në 430 000 000 euro.

Mossad

Agjencia jashtë mase aktive e Inteligjencës së Izraelit është përgjegjëse për grumbullimin e informacioneve të fshehta, anti-terrorizmin dhe operacione të ndryshme të fshehta. Mossad është një shërbim civil dhe nuk përdor grada ushtarake, megjithatë pjesa më e madhe e punonjësve kanë shërbyer në Forcat e Mbrojtjes së vendit.

(www.besnikzeqiri.net)

(20.1) Kur CIA-s iu dha liri veprimi e madhe?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Gjatë Lutës së Parë Botërore.
- B. Gjatë Luftës së Ftohtë.
- C. Gjatë Lutës së Dytë Botërore.

1 pikë

(20.2) Pse u themelua fillimisht MI6?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Për të shkëmbyer informacione.
- B. Për të shkaktuar goditjen e shumë regjimeve.
- C. Për të mbikëqyrur aktivitetet e Gjermanisë.

1 pikë

(20.3) Kush e formoi GRU-në?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Boris Jelcini.
- B. Mihail Gorbaçovi.
- C. Vladimir Iliç Lenini.

1 pikë

(20.4) Shërbim i Inteligjencës së cilit shtet është DGSE?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. I Gjermanisë.
- B. I Francës.
- C. I Rusisë.

1 pikë

(20.5) Çfarë funksioni ka pasur më parë BND?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Ta vëzhgojë Bashkimin Sovjetik.
- B. Ta njoftojë Qeverinë gjermane.
- C. Ta risë buxhetin vjetor.

1 pikë

(20.6) Çfarë shërbimi është Mossadi?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Civil.
- B. Ushtarak.
- C. Policor.

1 pikë

NDARJA E ÇMIMIT NOBEL ÇMIMI NOBEL NË DUART E MË MERITORËVE

Çmimet Nobel për vitin 2008 nga fusha e letërsisë, fizikës, mjekësisë, kimisë dhe ekonomisë iu ndanë shkencëtarëve eminentë. Në ceremoninë e organizuar në Stokholm çmimet i dha mbreti suedez Karl Gustav XVI.

Nobelisti i fizikës ka 87 vjet

Nënshtetasi amerikan i lindur në Japoni Joiçiro Nambu, bashkë me dy fizikanët japonezë, të cilët zbuluan pjesë të vogla të atomit e morën çmimin Nobel për fizikë në vitin 2008. Sipas informatave 87 vjeçari Joiçiro Nambu nuk ka mundur të marrë pjesë në ceremoninë e ndarjes së çmimit në Suedi, për shkak të moshës dhe gjendjes së brishtë shëndetësore. Dy fizikanët e tjerë, me të cilët Nambu ndan çmimin Nobel për fizikë, shkencëtarët japonezë Makoto Kobojsi dhe Toshhide Masakava ishin prezent në ndarjen e çmimit.

Tre shkencëtarë e ndanë çmimin me vlerë 950 mijë euro

Gjatë ceremonisë u nda edhe çmimi për mjekësi tre shkencëtarëve. Herald Zur Hausenit nga Gjermania për zbulimin e Human Papiloma (HPV), virusi që shkakton kancerin në qafën e mitrës dhe francezëve Fransoa Bar – Sinuzi dhe Lik Montanje për zbulimin e virusit HIV, i cili shkakton AIDS-n. Të tre shkencëtarët e ndanë çmimin me vlerë 950 mijë euro.

Çmimi Nobel për kimi për vitin 2008 u takoi shkencëtarëve Roxher Cien dhe Martin Shalfi nga Amerika dhe Osamu Shimomura nga Japonia për kërkimet e bëra në fushën e proteinave fluoreshente.

Çmimi Nobel për letërsi për vitin 2008 i takoi shkrimtarit francez Zhan – Mari le Klezo, i cili mori pjesë në ndarje.

Çmimi Nobel për ekonomi iu nda amerikanit Pol Krugman për kërkimet e bëra në temë „Vendi i aktiviteteve ekonomike dhe konstrukti i tregtisë”.

Gjatë solemnitetit që çdo vit organizohet në kryeqytetin e Norvegjisë Oslo, burrshtetasit dhe diplomatit finlandez Marti Ahtisari (71 vj.) iu nda çmimi Nobel për paqe në vitin 2008.

Gjatë mbajtjes së solemnitetit në Stokholm të shpërblyerve u ndanë edhe medalje të arta, diploma dhe çek prej rreth 10 milionë korona suedeze (950 mijë euro). Çmimi Nobel për paqe ndahet në Oslo, kurse çmimet për mjekësi – fiziologji, fizikë, kimi, letërsi dhe ekonomi ndahen në solemnitetin e organizuar në Stokholm. Solemnitetet organizohen me 10 dhjetor, në ditën e vdekjes së themeluesit të çmimit Nobel, Alfred Nobel.

(21.1) Ku ndahen çmimet Nobel?

1 pikë

1	2
---	---

(21.2) Kush i ndau çmimet Nobel në vitin 2008?

1 pikë

1	2
---	---

(21.3) Kush janë fituesit e çmimit Nobel për fizikë në vitin 2008?

1 pikë

1	2
---	---

(21.4) Kujt i takoi çmimi Nobel për letërsi në vitin 2008?

1 pikë

1	2
---	---

(21.5) Ku u mbajt dorëzimi i çmimit Nobël për paqe në vitin 2008?

1 pikë

1	2
---	---

(21.6) Kush është themelues i çmimit?

1 pikë

1	2
---	---

Republika e Maqedonisë – sipas Kushtetutës të vitit 1991
Liritë politike

E DREJTA E BARAZISË DHE E BARASVLERËS

E drejta e barazisë, para së gjithash, përfshin barasvlerën politike – juridike të qytetarëve dhe ka të bëjë me mohimin e çdo lloj diskriminimi të qytetarit kundrejt ligjit, si dhe me gëzimin e të drejtave juridike. Kjo e drejtë është rrjedhojë e revolucioneve demokratike borgjeze të shek. XVIII dhe deri më sot zhvillohet vazhdimisht, kurse brendia e saj pasurohet.

E drejta e barasvlerës, të cilën Kushtetuta e shpreh me formulimin se qytetarët janë të barasvlerëshëm në liritë dhe në të drejtat pavarësisht gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes etnike e sociale, bindjes politike e fetare, pozitës shoqërore e materiale dhe se ata janë të barasvlerëshëm para ligjit, është njëra nga të drejtat më të rëndësishme, sepse ajo është një vlerë themelore për realizimin e të gjitha lirive dhe të drejtave të njeriut dhe në qenien e vet i mohon diskriminimin, privilegjet dhe përparësitë e çdo lloji e të çdo baze.

Absolutizmi i karakterit i këtij ligji veçanërisht gjen shprehje dhe e thekson rëndësinë e vet në shoqëri, në të cilën akoma ekzistojnë dallime ekonomike ndërmjet funksioneve drejtuese dhe ekzekutive, ndërmjet pozitës dhe ditorisë, ndërmjet punës intelektuale dhe asaj fizike. Barazia dhe barasvlera, pa marrë parasysh arsimimin dhe pozitën shoqërore, kërkojnë marrëdhënie ku nuk ekzistojnë të privilegjuar as në bazë të ditorisë e veçanërisht jo në bazë të pozitës dhe funksionit. Ky parim është në kundërshtim të thellë me çdo teori të “aristokracisë së shpirtit” dhe të „elitës së zgjedhur”, si dhe me çdo strukturë shoqërore e politike burokratike dhe hierarkike.

Dëshmia më konsekuente e kësaj të drejte të qytetarëve është parimi sipas të cilit “të gjithë janë të barabartë para ligjit”. Ky parim, të cilin e përmbajnë pothuaj të gjitha kushtetutat e botës, në fakt, paraqet dëshmi të parimit për liri të njeriut nga çdo lloj diskriminimi. Ky parim e detyron ligjdhënësin në mënyrë të posaçme, me ndalim të thuktë të kushtetutës, në ligjet të përfshihen nene me të cilat bëhet dallim mes njerëzve, si dhe paraqet obligim për të gjitha organet, të cilat e zbatojnë ligjin dhe aktet e tjera, zbatimin ta bëjnë njëllë ndaj të gjithëve, që do të thotë në raste të njëjta të marrin vendime të njëjta, duke mbajtur llogari për veçantitë e rastit dhe individualizimin e tij sipas karakterit e jo sipas pjesëmarrësve.

Barazia dhe barasvlera pa marrë parasysh kombësinë kanë rëndësi të posaçme për bashkësinë tonë shumëkombëshe, sepse e përjashtojnë pozitën e privilegjuar të kombeve të veçanta në bazë të numrit të tyre, nivelit kulturor dhe fuqisë materiale dhe e pamundësojnë pozitën e tyre dominuese në Republikë ose në pjesë të caktuara të saj. E ngjashme është vlera e këtij parimi në bazë të bindjes fetare, sepse ai përjashton çdo lloj diskriminimi të kësaj baze, kurse bindja fetare nuk mund të jetë pengesë në punën dhe në angazhimin politik të qytetarëve dhe ky parim njëkohësisht paraqet bazë të mirë për tolerancën fetare në shoqëri.

Duke e pranuar edhe klauzolën kundër racizmit që është verifikuar në Deklaratën universale për të drejtat e njeriut dhe në dokumente të tjera të Kombeve të Bashkuara si dhe në përcaktimet dhe përpjekjet politike të të gjitha vendeve demokratike, Kushtetuta këtë e deklaroi me parimin e barazisë dhe të barasvlerës në bazë të racës.

Barazia dhe barasvlera, pa marrë parasysh gjininë është çështje civilizimi që manifestohet me krijimin e të gjitha kushteve për barazi të grave dhe të burrave e veçanërisht në ndryshimin e sjelljes së përgjithshme të shoqërisë ndaj gruas.

Provimet pranuese
Shkup, 1996
Universiteti „Shën Qirili e Metodi” – Shkup

(22.1) Teksti i dhënë, sipas stilit është tekst:

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. artistik - letrar.
- B. bisedor.
- C. shkencor - libror.

1 pikë

(22.2) Rrjedhjet e cilave ngjarje historike është e drejta e barazisë dhe e barasvlerës?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Rrëzimit të murit të Berlinit.
- B. Revolucioneve demokratike borgjeze të shek XVIII.
- C. Luftës së Dytë Botërore.

1 pikë

(22.3) Në qenien e vet e drejta e barasvlerës mohan:

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. përkatësinë gjinore.
- B. diskriminimin, privilegjet dhe përparësitë.
- C. përkatësinë fetare.

1 pikë

(22.4) Teoritë diskriminuese që janë në kundërshtim me parimin e barasvlerës janë:

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. teoritë e „aristokracisë së shpirtit” dhe të „elitës së zgjedhur”.
- B. teoria „kundër racizmit”.
- C. teoria e „tolerancës fetare”.

1 pikë

(22.5) Parimi i barazisë, të cilin e përmbajnë pothuaj të gjitha kushtetutat e botës thotë:

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. „Të gjitha gratë janë të barabarta para ligjit”.
- B. „Të gjithë punëtorët janë të barabartë para ligji”.
- C. „Të gjithë janë të barabartë para ligjit”.

1 pikë

(22.6) Në Kushtetutën tonë qëndrimi kundër racizmit deklarohet me parimin e barazisë dhe të:

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. barasvlerës në bazë të racës.
- B. barasvlerës në bazë të religjionit.
- C. barasvlerës në bazë të gjinisë.

1 pikë

THEMELIMI I QYTETIT TË OHRIT

Në qoftë se e kërkojmë kohën e themelimit të qytetit të Ohrit, gjurmët do të na çojnë në thellësitë e shekujve kur njeriu në këtë regjion, duke shfrytëzuar përparësitë e fushës së pasur dhe pasuritë e pashtershme të liqenit i krijon vendbanimet e tij të para. Lokalitetet e shumta të neolitit, të zbuluara në brigjet e liqenit, flasin për jetën e njeriut parahistorik të kësaj ane. Viteve të fundit arkeologët, nga dita në ditë hartën arkeologjike të regjionit me entuziazëm e plotësojnë duke shënuar zbulimet e reja që flasin për një jetë me vazhdimësi nëpër periudha të ndryshme kohore.

Stratigrafia e shtresave kulturore shpie nga në epoka në epokë duke prezantuar material të pasur. Dhe, kur hulumtuesit e kanë prekur periudhën halshtanike, në lokalitetet e qytetit të sotëm dhe në rrethinën e ngushtë të tij, begatia e zbulimeve, përpunimi i tyre teknik dhe vlerat zejtare dhe artistike, vunë nën hije çdo gjë që ishte parë dhe zbuluar gjer atëherë në këtë pjesë të Gadishullit Ballkanik. Maskat dhe sandalet e arta, enët me forma të ndryshme, vathët, unazat dhe zbukurimet e tjera prej ari, argjendi dhe bronzi, flasin jo vetëm për pasurinë e këtij qyteti në këtë periudhë të hershme kohore, por edhe për mjeshtrinë e madhe të krijuesve të tyre dhe për shijen e stërholluar të atyre që i kanë porositur dhe shfrytëzuar. Emrat e lokaliteteve arkeologjike: „Trebenishtë”, „Vajtos”, „Deboj” dhe „Lihnid” u bënë të njohur mes arkeologëve në gjithë botën.

Lihnidosi i vjetër, Ohri i sotëm ka qenë qendër e fisit ilir Desaret dhe një qytetet i rëndësishëm i magjistrates Via Ignacia – lidhja tokësore e detit Egje dhe Jon.

Në qoftë se zbulimet e periudhës ilire në të shumtën e rasteve kanë qenë dhurata të ruajtura në nekropole, të lidhur me kultin e të vdekurve, periudha helenike, e më vonë edhe periudha e sundimit romak ofron ndërtime monumentale në vetë qendrën e qytetit. Mes tyre, pa dyshim një vend i posaçëm i takon teatrit të madh. Sot ky teatër, akoma në fazë të zbulimit, me formën, madhësinë mënyrën e ndërtimit të tij dhe me materialin e përdorur ndërtimor dëshmon për jetën e pasur kulturore të qytetit që në shekullin e tretë para erës sonë, kur ka filluar ndërtimi i tij. Anekset dhe zgjerimet e mëvonshme, si dhe adaptimet e caktuara, të cilat zgjasin gjer më shekullin e dytë të erës sonë, flasin për rolin e padiskutueshëm të teatrit nëpër shekuj, jo vetëm në qytetin Lihnidos, por edhe më gjerë.

Marrë nga

OHRI

VEND KULTOROR-HISTORIK DHE NATYROR

NË LISTËN E TRSHËGIMISË BOTËRORE

Enti Grafik i Kroacisë, Zagreb, 1987

(23.1) Cilës periudhë i takojnë lokalitetet, të cilat flasin për jetën e njeriut parahistorik të kësaj ane?

1 pikë

1

2

(23.2) Si quhet periudha arkeologjike zbulimet e së cilës vunë nën hije çdo gjë që ishte zbuluar gjer atëherë në Gadishullin Ballkanik?

1 pikë

1

2

(23.3) Cilat lokalitete arkeologjike të këtyre anëve janë të njohura në gjithë botën?

1 pikë

1

2

(23.4) Qendër e cilit fis ilir ka qenë Lihnidosi?

1 pikë

1

2

(23.5) Ç'ruajnë nekropolet?

1 pikë

1

2

(23.6) Cili ndërtim monumental në qendrën e Ohrit rrjedh nga periudha romake?

1 pikë

1

2

DIETA E HIDROKARBUREVE MUND TË SHKAKTOJË HUMBJEN E KUJTESËS

Është vërtetuar se gjatë dietës për humbjen e peshës, me pakësimin e ushqimit të pasur me hidrokarbure mund të shkaktohet humbja e memories.

Sipas gazetës Daily Mail, në një hulumtim të Universitetit të Bostonit Tafts në lidhje me testimin e kujtesës, është vërtetuar se kujtesa e njerëzve, të cilët gjatë dietës i shmangen ushqimit të pasur me hidrokarbure, është në gjendje më të keqe se kujtesa e njerëzve të cilët konsumojnë makarona, bukë dhe patate.

Shkencëtarët, të cilët theksojnë se hidrokarburet janë një burim i rëndësishëm i energjisë së trurit, kanë vërtetuar se vetëm pas një jave nga fillimi i dietës së Atkinsonit, performancat e trurit zvogëlohen.

Udhëheqësi i hulumtimit Holi Tejlor thotë se gjatë hulumtimit është vërtetuar se, dietat moderne me të cilat zvogëlohet përdorimi i hidrokarbureve ose me të cilat tërësisht shmangen ato, kanë ndikim tejet negativ në të menduarit dhe në kretivitetin.

Hulumtimi është bërë mes grave të moshës 25 - 55 vjeçare. Një pjesë e pjesëmarrëseve i është nënshtruar dietës me pakësimin e kalorive, kurse pjesa tjetër dietës me pakësimin e hidrokarbureve.

Në testimet për kujtesën që janë bërë një javë pas fillimit të dietës, është konstatuar se ato pjesëmarrëse që kanë mbajtur dietë me konsumim të ushqimit që ka pak kalori, kanë treguar rezultate më të mira se të tjerat, të cilat kanë mbajtur dietë me pakësimin e hidrokarbureve.

Dieta më e njohur me pakësimin e ushqimit me hidrokarbure, me të cilën ndalohet përdorimi i miellit, sheqerit, patateve dhe i ushqimit të ngjashëm që përmban hidrokarbure e me të cilën lejohet konsumimi i proteinave dhe yndyrave, është dieta e diskutueshme e Atkinsonit.

(24.1) Çfarë mund të shkaktohet me pakësimin e ushqimit të pasur me hidrokarbure?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Humbja e koncentrimin.
- B. Humbja e memories.
- C. Humbja e baraspeshës.

1 pikë

(24.2) Cila gazetë i shpalli njohuritë e hulumtimeve të Universitetit të Bostonit Tafts?

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. New York Times.
- B. Washington Post.
- C. Daily Mail.

1 pikë

(24.3) Hidrokarburet janë një burim i rëndësishëm i energjisë së:

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. trurit.
- B. zemrës.
- C. mëlçisë.

1 pikë

(24.4) Dieta e hidrokarbureve ka ndikim tejet negativ në:

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. të folurit dhe të shprehurit.
- B. të menduarit dhe kreativitetin.
- C. të perceptuarit dhe të vlerësuarit.

1 pikë

(24.5) E diskutueshme është dieta e:

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. Tejlorit.
- B. Atkinsonit.
- C. Taftsit.

1 pikë

(24.6) Në fjalinë „Dieta e hidrokarbureve mund të shkaktojë humbjen e kujtesës”, togfjalëshi humbjen e kujtesës është:

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. kundrinë e zhdrejtë.
- B. kryefjalë.
- C. kundrinë e drejtë.

1 pikë

FAQE E ZBRAZËT

FAQE E ZBRAZËT

FAQE E ZBRAZËT